



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 746/12 Prot.

Pogradec, më 22.02.2022

VENDIM

NR. 17, DATË 18.02.2022

PËR

**LIDHJEN E MARRËVESHJES SPECIFIKE ME MINISTRINË E
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË, PËR KRIJIMIN E SUBJEKTIT TË
KOMPETENCAVE TË PËRBASHKËTA, PËR KRYERJEN E VEPRIMTARISË SË
FURNIZIMIT ME UJË, LARGIMIN DHE PËRPUNIMIN E UJRAVE TË
NDOTURA NË ZONAT E SHËRMBIMIT, NË TERRITORIN E BASHKISË
POGRADEC.**

Në mbështetje të; Ligjit Nr. 8417, datë 22.11.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", I ndryshuar, pikës 1 dhe pikës 2 të nenit 3 "Koncepti I autonomies vendore" dhe nenit 4 "Rëndësia e autonomies vendore" të Ligjit Nr.8548, datë 11.11.1999 "Për ratifikimin e "Kartës Europiane të Autonomisë Vendore", pikës 2 të nenit 8, pika 5 e nenit 14, shkronjës "gj" të nenit 54, të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", I ndryshuar, Ligjit Nr.8480, date 27.5.1999, "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administrates shteterore dhe enteve publike", Ligji Nr.8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", I ndryshuar, Ligji Nr.9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", I ndryshuar, Ligjit Nr. 44/2015, "Kodi I Proçedurave Administrative I Republikës së Shqipërisë", Ligjit Nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil I Republikës së Shqipërisë", I ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 431, datë 11.7.2018 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e agjencisë kombëtare të ujësjellës-kanalizimeve dhe infrastructures së mbetjeve", bazuar në shkresën e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 950 Prot, datë 28.01.2022, "Mbi reformën në Sektorin e Ujësjellës Kanalizime", e protokolluar pranë Bashkisë Pogradec Nr. 559 Prot, datë 01.02.2022 dhe në relacion I paraqitur, me propozim të Kryetarit të Bashkisë.

KËSHILLI I BASHKISË

VENDOSI :



1. Të japë pëlqimin për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta, për kryerjen e veprimtarisë së furnizimit me ujë, largimin dhe përpunimin e ujrave të ndotura në zonat e shërbimit, në territorin e Bashkisë Pogradec.

2. Të autorizohet Kryetari I Bashkisë Pogradec për lidhjen e marrëveshjes specifike me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta, për kryerjen e veprimtarisë së furnizimit me ujë, largimin dhe përpunimin e ujrave të ndotura në zonat e shërbimit, në territorin e Bashkisë Pogradec.

3. Efektet: Në përmbushje të detyrimeve ligjore mbi Reformën në Sektorin e Ujësjellës Kanalizimeve.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Kryetari i Bashkisë dhe Ujësjellës Kanalizime Pogradec sh.a.

5. Vendimi të hyjë në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

6. U shpall sot mëdatë _____. _____. 2022.

KRYETAR I KËSHILLIT

Sotiraq MANGËRI

